

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2021*

24.04.2021

Ora 16:15

RENDI I DITËS

Hedhja e shortit për “ Caktimin e Relatorit të Kërkesës Ankimore nr.24”

PJESËMARRJA :

- **KAS:**
- **Stafi KQZ: Y.Merkaj, O.Peto**
- **Parti Politike:**

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje, pranë KQZ-së është paraqitur 1 Kërkesë Ankimore. Kërkesa Ankimore nr.24 datë 24.04.2021 ora 13:00 me ankues subjektin Partia Bindja Demokratike, me objekt kundërshtimi i vendimi të KZAZ-së nr.39, nr.10 datë 23.04.2021 për refuzimin e listës së vëzhguesve të subjektit zgjedhor Partia Bindja Demokratike. Sipas nenit 14, të vendimit nr.3, të Komisionit Rregullator për mitatimin e Rregullores së KAS-it do të zhvillohet shorti për caktimin e relatorit, për shqyrtimin e kërkesës ankimore të paraqitur pranë KQZ-së. Procedura e shortit është e njëjtë si ka qenë dhe më parë. Administrata e KQZ-së ka përgatitur 5 shirita letre dhe 5 gogla me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë. Në 1 nga 5 shiritat e letrës është vendosur shkrimi “Kërkesë Ankimore nr.24”. Atëherë 5 shiritat janë futur në goglat me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë të tejdukshme. Një përfaqësues i Administratës i vendos shiritat nëpër gogla dhe bën përzierjen e tyre. Sipas nenit 14 të rregullores së KAS-it pika “ç” një përfaqësues i KQZ-së do të tërheqi gogllën, sipas rendit alfabetik rritës, në emër dhe për llogari të anëtarëve të KAS-it.

Për Z. E. Lako: Tërhiqet gogla - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Zbardhi materialin audio

Silvi Sino



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2021*

Për Z. E. Çefa: Tërhiqet gogla - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. I. Rusmali: Tërhiqet gogla - në shirit është Kërkesa Ankimore nr.24.

Për Z. K. Bele: Tërhiqet gogla - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. L. Braho: Tërhiqet gogla - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të rezultatit të shortit administrata e KQZ-së bën publik rezultatin nga i cili zoti Ilirjan Rusmali u përzgjedh Relator i Kërkesës Ankimore nr.24.
Procedurën e shortit e deklaroj të mbyllur, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2021*

**24.04.2021
Ora 19:02**

RENDI I DITËS

**Projektvendimi "Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.24, subjekti
ankues Partia Bindja Demokratike".**


PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE(Nuk është prezent), Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** S'ka

Z.I.Rusmali: Çelim seancën përgatitore për shqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor, Bindja Demokratike. Kërkesë ankimore kundër vendimit të KZAZ-së nr.29, për mospranimin e vëzhguesve të këtij subjekti zgjedhor. Vendimi është nr.10, datë 23.04.2021. Subjekti ankues është njoftuar nga administrata e KQZ-së, nuk është prezent në këtë seancë të shqyrtimit paraprak, por ne mund ta vazhdojmë seancën dhe pa prezencën e tij. Prezentë janë, sekretari i Përgjithëm i KQZ-së me përfaqësuesit e tjerë të administratës, të cilët unë i ftoj të na trajtojnë çështjen e aspekteve formale të kësaj kërkesë.

Z.Y.Merkaj: Pra, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është depozituar kërkesa ankimore me nr.24, në datë 24.04.2021, me ankues Partia Bindja Demokratike, e cila ankimon vendimin e KZAZ-së nr.29, vendimi nr.10, datë 23.04.2021, i cili ka refuzuar listën e vëzhguesve të paraqitur nga subjekti zgjedhor Bindja Demokratike. Në bazë të nenit 130 të Kodit Zgjedhor, kërkesa i është drejtuar

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2021*

Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, i cili është organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve, e vendimeve të KZAZ-ve, legjitimohet në, të kësaj kërkesë, pasi është subjekt zgjedhor, i cili garon në zgjedhjet e datës 25 prill 2021 dhe i cënohen të drejtat e këtij subjekti për të caktuar vëzhgues për numërimin e votave. Gjithashtu kërkesa nga ana formale është korrekte, pasi është sipas modelit të përcaktuar dhe të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është brenda afatit, pasi vendimi është marrë në datë 23.04.2021 dhe ankimi është dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në datë 24.04.2021. Kështu të tre elementet e formës i plotëson dhe duhet të kalojë për shqyrtim, sipas propozimit të administratës.

Z.I.Rusmali: Faleminderit për sqarimet rreth çështjes! Kolegët kanë ndonjë pyetje, ndonjë çështje për të ngritur? Nuk kanë? Besoj jemi dakord ta kalojmë për shqyrtim? Komisioni vendos të kalojë për shqyrtim këtë kërkesë ankimore. Procedojmë me shqyrtimin direkt? Komisioni vendos që të procedojmë me shqyrtimin e kërkesës ankimore menjëherë, kështu që tani mund të përgatitemi për kalimin.

Vendimi nr. 43

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2021*

24.04.2021
Ora 19:06

RENDI I DITËS

**Projektvendimi "Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr.24, subjekti ankues Partia
Bindja Demokratike".**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** S'ka

Z.I.Rusmali: Mirë, atëherë çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.24, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Bindja Demokratike, ankim kundër vendimit nr.10, datë 23.04.2021, të KZAZ-së nr.29, për refuzimin e akreditimit të vëzhguesve të këtij subjekti pranë kësaj KZAZ-je. Për nga objekti, çështja është tashmë e trajtuar në një seri vendimesh të KAS-it dhe besoj nuk do kemi ndonjë vështirësi për ta trajtuar këtë çështje, subjekti nuk ndodhet prezent, pavarësisht se është njoftuar për zhvillimin e kësaj seance sot, në ora 19:00, gjithsesi ne mund të vazhdojmë. Ndonjë kërkesë nga anëtarët e KAS-it? Nuk ka, lidhur me konfliktin e interesave? Do t'i kërkoja sekretarit të Përgjithshëm të na prezantoj shkurtimisht përmbajtjen e kërkesës.

Z.Y.Merkaj: Komisioni i Zonës Administrim Zgjedhor nr.29 ka refuzuar kërkesën e subjektit zgjedhor, Partia Bindja Demokratike për anketimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e procesit zgjedhor të datës 25 prill 2021, pasi është jashtë afatit ligjor.

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Dt.24.04.2021

Kundër këtij vendimi, subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike nuk është dakord dhe ka ankimuar këtë vendim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me kërkesën e depozituar pranë protokollit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në datën 24.04.2021, ora 13:00, me kërkesën ankimore nr.24. Çështja pasi është hedhur në short, është shpallur rezultati i shortit, i cili rezultati i shortit është zoti Ilirjan Rusmali, relator i kërkesës ankimore nr.24, çështja është për shqyrtim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve. Faleminderit!

Z.I.Rusmali: Mirë, faleminderit për shpjegimet rreth kësaj çështje. Kolegët kanë ndonjë pyetje për administratën, ndërkohë? Po, zoti Braho?

Z.L.Braho: Unë vetëm një pyetje kisha, se këtu nuk del. Çfarë date e ka depozituar Bindja Demokratike kërkesën tek KZAZ-ja 29 për akreditimin e vëzhguesve?

Z.Y.Merkaj: Më datë 23.04.2021.

Z.L.Braho: Ditën e djeshme i ka depozituar?

Z.Y.Merkaj: Po, ditën e djeshme!

Z.I.Rusmali: Pyetje tjetër? Mirë, nuk ka pyetje të tjera. Do tërhiqemi për vendim? Me shumë të drejtë kolegët referojnë tek seria e vendimeve që ka marrë KAS-i dhe për të cilat ne iu jemi lutur njëherë por do ju lutemi prap që të informoni ato KZAZ që kanë çështje të hapura me akreditimin, që akreditimi i vëzhguesve të subjekteve politike duhet të bëhet për motive të rëndësishme ligjore që janë shpjeguar në vendimin tonë. Gjithsesi komunikoj vendimin unanimit të KAS-it lidhur me këtë

***Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA***



***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2021***

kërkesë ankimore. KAS-i vendosi pranimin e kërkesës ankimore, detyrimin e KZAZ-së nr.29 që të bëjë akreditimin e vëzhguesve të subjektit Bindja Demokratike sipas kërkesës paraqitur nga ky subjekt. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet në faqen zyrtare të KQZ-së. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve. Këtu e mbyllim këtë seancë.

Vendimi nr. 44

***Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA***

